

FJALA E DEPUTETES MERITA BAKIU

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Të nderuar qytetarë,

Dje ishte data 1 mars. Muaji mars është muaji i festës së nënave dhe motrave, por ndodhi ajo që nuk duhej të ndodhte kurrë: Dje Shqipëria u trondit nga një prej ngjarjeve më të mëdha kriminale në vend, ku dhuna ndaj grave mori përmasa tragjike. Si nënë dhe si grua jam e tronditur nga vrasja e tri zonjave dhe plagosja e tri të tjerave nga dora kriminale, e cila duhej të ishte në burg, sepse po kjo dorë kriminale para disa vitesh, ka marrë jetën e një gruaje tjetër. Si kryetare e Aleancës së Grave Deputete, i ftoj të gjitha zonjat që ta dënojmë maksimalisht këtë akt, të bëhemi të gjitha bashkë për të parandaluar që ngjarje të tilla të mos ndodhin më. Kjo ngjarje tregon se kanë dështuar policia, shteti, institucionet, drejtësia dhe gjykata. Në një vend normal, me një qeveri normale, më e pakta sot duhej të jepnin dorëheqjen ministri i Brendshëm dhe ai i Drejtësisë.

Të nderuar qytetarë,

Sot në këtë interpelancë, edhe pse të vonuar prej më shumë se një muaji, Kryeministri i vendit është thirrur për të dhënë llogari jo pse ia kërkon opozita e vendit, por, sepse është detyrim i tij në respektim të Kushtetutës së vendit. Kjo keqqeverisje, tashmë në vitin e 10-të saj, është përgjegjëse për një sërë aferash korruptive, që kanë tronditur besimin e qytetarëve shqiptarë dhe mbarë opinionin publik. Mazhoranca dhe Kryeministri i vendit duhej të mbanin përgjegjësi dhe të përballëshin edhe më herët në interpelancat në këtë Kuvend. Por kjo aferë korruptive “McGonigal-Edi Rama”, nuk është thjesht një aferë e radhës, ku paratë publike, taksat e shqiptarëve janë keqpërdorur dhe janë tjetërsuar për qëllimet e pushtetarëve. Rasti i korrupsionit “McGonigal-Rama” është një aferë e paprecedent. Është afëra korruptive më tronditëse e 30 vjetëve të fundit në Shqipëri.

Tashmë opinionin publik shqiptar, por, fatkeqësisht, edhe ai ndërkombëtar, për shkak të përfshirjes së një zyrtari të lartë amerikan në të, është njohur me aferën e korrupsionit të Edi Ramës, i cili nëpërmjet një ish-agjenti të ish-Sigurimit të Shtetit, ka korrumpuar agjentin McGonigal me së paku 225 mijë dollarë amerikanë për qëllime të pastra politike në shërbim të Kryeministrit Edi Rama. Edi Rama është provuar jo një herë, por së paku 14 herë, sipas aktakuzës së drejtësisë amerikane, për lidhjet e tij të ngushta me McGonigal-in. Kjo miqësi e beftë e Kryeministrit të vendit me një zyrtar amerikan nuk na bën të çuditemi sa i përket aspektit personal, sepse faktet kanë treguar se Edi Rama është mik dhe bashkëpunëtor me bandat e kriminelëve dhe organizuar shqiptar, e faktuar kjo në përgjimet e dosjeve nr. 184 dhe nr. 339 për zgjedhjet në Dibër dhe në Durrës të disa viteve më parë. Edi Rama është kapur disa herë gafil për lidhjet e tij korruptive për koncesionet dhe PPP-të abuzive, që po rëndojnë çdo vit me qindra milionë euro taksat e qytetarëve shqiptarë, duke ua hequr shërbimeve, politikave në mbështetje të qytetarëve, të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë dhe infrastrukturës, e për t’ua dhënë bashkëpunëtorëve të tij. Edi Rama është personi kyç në aferën e inceneratorëve, djegësive të disa qindra milionë eurove, ku deri më tani, që kanë nisur zyrtarisht hetimet në SPAK, është faktuar se janë paguar plot 100 milionë euro. Opozita e dëshmoi një vit më parë këtë aferë e lidhje korruptive në komisionin hetimor parlamentar. Edi Rama është provuar nga drejtësia amerikane se është i përfshirë kokë e këmbë në aferën më të madhe dhe më skandaloze për vendin tonë. Si një vend aleat i SHBA-ve ne duhet t’u jemi mirënjohës që prej mbështetjes për shtetformim, por edhe për suportin që ato

na dhanë gjatë regjimit totalitar komunist nëpërmjet kanaleve dhe instrumenteve për diasporën e më gjerë, në vijim tashmë me anëtarësimin e vendit në NATO dhe në reformën në drejtësi. Për një muaj rresht Edi Rama refuzoi të përballlej me qytetarët, në radhë të parë, pikërisht në këtë parlament, me agorën e demokracisë, ku secili prej nesh është përgjegjës pasi përfaqëson qytetarët, vullnetin e tyre, votën e tyre e për pasojë dhe vendimmarrjen e tyre. U përpoq me çdo mënyrë, duke përdorur dhe vetë Kryetaren e Kuvendit (që, si grua, më vjen keq që i drejtohem), vetëm e vetëm për t'u fshehur pas përgjegjësisë që ka si Kryeministër në zbatim të Kushtetutës së Republikës dhe të përgjegjësisë për llogaridhënie para qytetarëve. Ai përdori çdo instrument edhe kundër Rregullores së këtij Kuvendi, duke u përpjekur t'ia mbyllë gojën opozitës. Po ashtu, me përjashtimet masive ndaj deputetëve të opozitës, si asnjë herë më parë, në kohën e pluralizmit, kur i heq të drejtën një deputeti të ushtrojë detyrën e tij, është një hap larg autoritarizmit absolut. Edi Rama sot do të duhet t'u përgjigjet qytetarëve në këtë sallë, për këtë aferë korrupsioni të pastër, duke përdorur para të pista, influencën e tij politike, duke anatemuar e krijuar histori e llojlloj gënjeshtresh e manipulimesh për kundërshtarët politikë, duke korrupuar një punonjës të lartë të FBI-së. Nga ana tjetër, drejtësia shqiptare duhet të veprojë sa më parë, ta marrë të pandehur vetë Edi Ramën. Mjafton të kërkojë dosjen e plotë, duke përdorur kanalet diplomatike, ashtu siç e parashikon dhe ligji për bashkëpunimin ndërkombëtar në gjyqësor dhe të nisë menjëherë hetimet zyrtare, për të hedhur dritë mbi çdo nivel të kësaj afere. Drejtësia duhet të jetë hapi i radhës, sepse shqiptarët nuk mund të mbajnë në krye një Kryeministër, i cili, me aferat e tij të panumërta dhe me këtë megaafere korruptive, do të vazhdojë të dëmtojë reputacionin dhe imazhin e vendit tonë sikur të ishim një shëmbëlltysë "putiniane" dhe jo një vend që aspiron të integrohet në familjen e madhe europiane sa më shpejt. Ju faleminderit.